



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

ANALIZA E PUNËS SË ISHMT-së 2021

TIRANË 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1. ARRITJET KRYESORE.....	3
2. OBJEKTIVAT KRYESORE.....	4
AKTIVITETET E REALIZUARA PËR 2021.....	4
3. INSPEKTIME PËR RESPEKTIMIN E KRITEREVE LIGJORE.....	4
3.1 Inspektime për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore.....	4
3.1.1 Inspektimi Metrologjik	4
3.1.2. Produkte elektrike	5
3.1.3 Produkte mekanike.....	6
3.1.4 Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme	6
3.2. Inspektime për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.....	8
3.2.1 Inspektimi mbi të drejtën e autorit	8
3.2.2 Inspektime mbi pronësinë industriale	8
4. AKTIVITETEVE SENSIBILIZUESE/INFORMUESE	9
5. NGRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETETEVE.....	11
6. MBËSHTETJE PËR PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E VEPRIMTARISË TË ISHMT-SË	13
7. DETYRATE PAREALIZUARA OSE TË REALIZUARA PJESËRISHT	14
7.1. Arsyet e mosrealizimit të çështjeve të parashikuara për vitin 2021.....	14
8. BURIMET NJERËZORE.....	16
8.1 Disiplina në punë, rekordet e orareve të punës.....	16
8.2 Performanca sipas kriterëve.....	16
8.3 Masa disiplinore të marra.....	16
8.4 Ngritje në detyrë, lëvizje paralele.....	16
8.5 Ankesat	17
9. MASAT E NDËRMARRA LIDHUR ME TASK FORCËN E ANTIKORRUPSIONIT	17
10. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022.....	17
11. PROBLEMATIKAT	19

1. ARRITJET KRYESORE

- ✓ Ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve joushqimore si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2021. Inspektimet e vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese, kanë ndihmuar në përpjekjet institucionale për të arritur këtë objektiv. Janë kryer në total **1745 inspektime** nga të cilat 1465 inspektime të programuara¹ dhe 280 jashtë programit mbi bazë ankimi². Janë vendosur **237 masa administrative në total** nga të cilat 93 paralajmërime, 121 gjoba dhe 23 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar **8124 produkte** nga të cilat 327 kanë qenë jo në konformitet.
- ✓ Bërja e evidencave ISHMT-së në tregun e produkteve joushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale, si një institucion që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjorë sipas fushës së veprimtarisë së tij. Informimi i operatorëve ekonomikë, konsumatorëve ka qenë gjithashtu në fokusin e punës së ISHMT-së nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të informacioneve në web-sitë www.ishmt.gov.al, rrjetet sociale, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.
- ✓ Informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin aktual, për të ofruar në treg produkte të sigurta si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo është arritur nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve të ndryshme të organizuar me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të fletëpalosjeve, botimeve informuese, emisioneve, intervistave televizive, etj. Në total janë realizuar **11 aktivitete sensibilizuese**.
- ✓ Fuqizimi i ISHMT-së dhe rritja e kapaciteteve njerëzore. Gjatë 2021 janë kryer në total **15 trajnime ku janë trajnuar 52 punonjës**.
- ✓ ISHMT ka dhënë kontributin duke qenë pjesë e grupeve të punës në: hartimin e 1 (një) draft ligji, 2 (dy) draft VKM, 2 marrëveshje bashkëpunimi, 1 (një) draft strategji dhe në raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si pjesë e GNP.

¹ “Inspektim i programuar” është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit për çdo inspektorat qendror apo vendor

² Inspektim jashtë programit konsiderohet inspektimi kur: a) nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektorat, nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore; b) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën ashëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin; c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a një organizatë ndërkombëtare; d) në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nganjë subjekt; e) në kushtet e flagrancës; etj.

2. OBJEKTIVAT KRYESORE

Objektivi kryesor:

Përmirësimi i sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale.

Objektivi 1: Zbatimi i kërkesave ligjore nga subjektet konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/instalime të sigurta për konsumatorin si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Objektivi 2: Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë mbi kriteret ligjore që duhet të zbatohen në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore, pronësisë intelektuale si dhe të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre.

AKTIVITETET E REALIZUARA PËR 2021

Për arritjen e objektivave, ISHMT ka punuar për përmbushjen e aktiviteteve të mëposhtme:

3. INSPEKTIME PËR RESPEKTIMIN E KRITEREVE LIGJORE

Në total nga ISHMT gjatë kësaj periudhe janë kryer 1745 inspektime nga të cilat 1465 inspektime të programuara dhe 280 jashtë programit mbi bazë ankimi. Janë vendosur 237 masa administrative në total nga të cilat 93 paralajmërime, 121 gjoba dhe 23 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 8124 produkte nga të cilat 327 kanë qënë jo në konformitet.

3.1 Inspektime për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore.

Inspektimet për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore përfshijnë kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore për metrologjinë, për produktet mekanike, produktet elektrike, qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme. Gjatë vitit 2021 janë kryer në total 1221 inspektime nga të cilat 959 inspektime të planifikuara dhe 262 inspektime jashtë programit të nxitura kryesisht nga ankesat. Janë vendosur 149 masa administrative në total nga të cilat 65 paralajmërime, 61 gjoba dhe 23 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 8124 produkte nga të cilat 327 kanë qënë jo në konformitet.

3.1.1 Inspektimi Metrologjik

Inspektimet në fushën e metrologjisë për vitin 2021 përfshijnë inspektimet për parapaketimet, instrumentat matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim dhe të vendosura në treg. Në total janë

kryer **515 inspektime** nga të cilat 331 të programuara dhe 184 të pa programuar mbi bazë ankese. Janë vendosur në total **4 masa administrative** me vendim gjobë.

Inspektime për parapaketim

Janë kryer **310 inspektime** të subjekteve që tregtojnë me pakicë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve. Gjatë inspektimeve të produkteve të parapaketuara është bërë edhe kontrolli i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara që kanë në përdorim prodhuesit apo importuesit e produkteve të parapaketuara (kryesisht peshore dhe dozatorë).

Janë kontrolluar **1384 produkte** nga të cilat 1 produkt ka qenë jo në konformitet. Është marrë **1(një) masë administrative** me vendim gjobë.

Inspektime për instrumenta matës

Janë kryer **28 inspektime** për instrumenta matës. Janë kontrolluar **705 instrumente matëse** ligjërish të kontrolluara në përdorim nga prodhuesit apo importuesit e produkteve të parapaketuara. Për këtë kategori produktesh nuk janë konstatuar produkte jo në konformitet.

Inspektime për Instrumentat matëse ligjërish të kontrolluara që vendosen në treg

Janë kryer **2 inspektime** të subjekteve që importojnë apo prodhojnë instrumente matëse ligjërish të kontrolluara. Është kontrolluar 1 tip instrumenti matës. Për këtë kategori produktesh nuk janë konstatuar produkte jo në konformitet.

Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, në përdorim

Janë kryer **175 inspektime** të subjekteve që kanë në përdorim instrumente matëse ligjërish të kontrolluara, kryesisht distributorë karburanti dhe gazi, peshore automobilistike dhe taksimetra. Janë kontrolluar 17 peshore automobilistike, 5 taksimetra, 1095 pistoleta karburanti dhe 111 pistoleta gazi, nga të cilat janë konstatuar 9 produkte jo në konformitet. Janë marrë në total 3 masa administrative me vendim gjobë.

3.1.2. Produkte elektrike

Inspektimet e produkteve elektrike për vitin 2021 përfshijnë inspektimet për produkte që mbulohen nga një rregull teknik si: frigoriferë, makina larëse, kondicionerë, furra shtëpiake, aspiratorë, aparate marrëse televizive, si dhe produkte që nuk mbulohen nga një rregull teknik si :adaptorë, priza dhe spina shtëpiake, etj.

Gjatë vitit 2021, në këto grup-produkte janë kryer në total **172 inspektime**³ nga të cilat 146 kanë qenë të programuara dhe 26 janë kryer jashtë programit mbi bazë ankimi. Numri i produkteve të

³Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, Ligjit nr.68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” , VKM Nr.

kontrolluara ka qenë **558 produkte** nga të cilat 50 kanë rezultuar jo në konformitet. Bazuar në këto gjetje u mor masa e ndalimit të tregtimit për 50 produkte (karikuesa, llamba, invertera, UPS, ndricuesa dekorativë etj.), në total mbi 2600 njësi. Janë vendosur **18 masa administrative** nga të cilat 6 gjoba dhe 12 masa urgjente.

3.1.3 Produkte mekanike

Në fokus të inspektimeve për këtë vit kanë qenë ashensorët, pajisjet e mbrojtjes personale dhe makineritë. Në total janë kryer **345 inspektime** nga të cilat **28** jashtë programit mbi bazë ankimi. Janë vendosur **95 masa administrative** gjithsej nga të cilat 61 paralajmërime, 2 masa urgjente dhe 32 gjoba.

Inspektime për ashensorët

Gjatë vitit 2021 janë kryer **336 inspektime** të subjekteve që kanë në përdorim ashensorë, apo vendosin në treg (instalojnë apo importojnë) ashensorë dhe komponentët e sigurisë për ta. Janë marrë në total **95 masa administrative** nga të cilat 32 gjoba dhe 61 paralajmërime dhe 2(dy) masa urgjente.

Në kuadrin e ngritjes së Regjistrimit kombëtar të ashensorëve, gjatë vitit 2021 **janë regjistruar 647 ashensorë**.

Inspektimi i PMP

Janë realizuar **28 inspektime** ku janë kontrolluar rreth 310 produkte për përmbushjen detyrimit të markimit CE si edhe Deklaratës së Konformitetit sipas Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqinmore”, i ndryshuar. Nga këto janë konstatuar 5 produkte jo në konformitet dhe si rezultat janë vendosur 6 masa administrative gjobë. Subjektet gjithashtu u këshilluan për detyrimet ligjore që duhet të përmbushin në lidhje me këto produkte.

Inspektimi i makinerive

Janë kryer **2 inspektime** të subjekteve që vendosin në treg makineri. Nuk është marrë asnjë **masë administrative**.

3.1.4 Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme

Gjatë vitit 2021 në fokus të inspektimeve të këtij sektori kanë qenë lodrat, mbrojtja e konsumatorit⁴ dhe siguria e përgjithshme. Në total janë kryer 189 inspektime nga të cilat të programuara 165 dhe 24 jashtë programit të nxitura nga ankesat dhe aktivitetet monitoruese. Janë vendosur në total

1061, datë 23.12.2015, Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara dhe rregullave teknike të miratuar për disa grup produktesh (kondicionerët e ajrit, makinat larëse, pajisje frigoriferike për përdorim shtëpiak, tharëse për përdorim shtëpiak, furra shtëpiake dhe aspiratorët thithës).

⁴Nëzbatim të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar.

32 masa administrative nga të cilat 4 paralajmërime, 19 gjoba dhe 9 masa urgjente. Janë kontrolluar **3685 produkte** në total nga të cilat 54 kanë qënë jo në konformitet.

Inspektimet për sigurinë e lodrave

Gjatë vitit 2021 janë realizuar **82 inspektime** të operatorëve ekonomikë importues dhe shpërndarës të produkteve lodra⁵. Në total përgjatë vitit 2021 janë kontrolluar **2607 produkte** lodra nga të cilat 25 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur **19 masa administrative** nga të cilat 11 gjoba dhe 8 masa urgjente.

Në kuadër të festave të fundvitit, ISHMT ka realizuar kontrole pranë operatorëve ekonomikë përgjegjës për vendosjen në treg të këtyre produkteve, duke qënë se kjo periudhë përkon edhe me nivelin më të lartë të bërjes së disponueshme të këtyre artikujve për konsumatorët. Kështu, gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor janë vendosur nën masën e ndalimit të tregtimit 3398 lodra të ndryshme. Informacioni mbi lodrat si foto/kod/barkod/numër artikulli/kategoria e riskut, u publikua në faqen zyrtare të ISHMT për të informuar publikun e gjerë. Po kështu u realizuan disa dalje në media kombëtare në emisione të dedikuara për Konsumatorët, për të rritur kështu ndërgjegjësimin e prindërve për kujdesin që duhet të tregojnë në përzgjedhjen e lodrave sa më të sigurta për fëmijët e tyre, duke kontrolluar markimet përkatëse dhe paralajmërimet, si dhe masat e marra nga ISHMT për të garantuar sigurinë e konsumatorëve lidhur me këto produkte.

Inspektimet për mbrojtjen e konsumatorëve

Janë realizuar **72 inspektime** ku janë kontrolluar rreth **745 produkte** për përmbushjen e detyrimit të informacionit në gjuhën shqipe, në përputhje me nenin 8, 9, 12 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, " Për mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar. Nga këto janë konstatuar 9 produkte jo në konformitet, dhe si rezultat janë vendosur **5 masa administrative** ku 3 prej tyre me paralajmërim dhe detyra për korrigjimin e shkeljeve dhe 2 me masë administrative gjobë.

Kategoria e produktit e përfshirë në këto inspektime ishin mallra të ndryshëm industrialë, detergjentë, veshje/tekstile. Produktet u kontrolluan për informacionin e nevojshëm në gjuhën shqipe që duhet t'u disponohet konsumatorëve referuar Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, " Për mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar. Subjektet gjithashtu u këshilluan për detyrimet ligjore që duhet të përmbushin në lidhje me këto produkte.

Inspektimet për sigurinë e përgjithshme

Gjatë vitit 2021 janë kryer **14 inspektime** për sigurinë e përgjithshme. Janë kontrolluar gjithsej 40 produkte artikuj fëmijësh përfshirë karrocet, rrethoret, biberonat dhe takëmet e fëmijëve në përputhje me standardet referuese që mbulojnë sigurinë e tyre⁶. Nga produktet e kontrolluara rezultuan 15 produkte jo në konformitet. Në total janë vendosur **2 masa administrative** nga të cilat 1 masë administrative me paralajmërim dhe 1 masë urgjente.

⁵ Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe VKM Nr. 262/2013 Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e lodrave".

⁶ VKM Nr.383/2020 Për miratimin e listës së standardeve me karakter referues për sigurinë e lodrave të vendosura në ambiente publike dhe private, EN1176.

3.2. Inspektime për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale

Inspektimet për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale përfshijnë inspektimet për Pronësisë Industriale dhe për të Drejtën e Autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me to.

Gjatë vitit 2021 janë kryer në total **524 inspektime** nga të cilat 506 kanë qenë inspektime të programuara dhe 18 inspektime të paprogramuara, mbi bazë ankese. Janë vendosur **88 masa administrative** nga të cilat 60 gjoba dhe 28 paralajmërimë.

3.2.1 Inspektimi mbi të drejtën e autorit

Në fokus të inspektimeve të Sektorit të të drejtavë të autorit kanë qenë: Inspektimi i programeve kompjuterike, veprave audiovizuale, fotokopje, shtëpi botuese, shtypshkronja, librari.

Gjatë vitit 2021, janë kryer në total **513 inspektime**⁷, nga të cilat 7 kanë qenë të nxitur nga ankesa. Janë informuar 510 subjekte. Janë vendosur 80 masa administrative nga të cilat 53 gjoba dhe 27 paralajmërimë.

Inspektimi i programeve kompjuterike

Gjatë vitit 2021 janë kryer në total **218 inspektime** mbi subjektet përdorues të programeve kompjuterike, nga të cilat 6 inspektime jashtë programit, të nxitura nga ankesat . Janë marrë gjithësej 33 masa administrative në total nga të cilat 12 gjoba dhe 21 paralajmërimë.

Inspektimi i Shtëpive Botuese/librari/fotokopje

Gjatë vitit 2021 janë kryer **68 inspektime** mbi kategoritë e përdoruesve të veprave letrare.

Inspektime të veprave audio-vizuale

Gjatë vitit 2021 janë kryer **227 inspektime** të veprave audio-vizuale. Janë marrë 47 masa administrative nga të cilat 41 gjoba dhe 6 paralajmërimë.

3.2.2 Inspektime mbi pronësinë industriale

Inspektimet mbi pronësinë industriale janë inspektime që kryhen vetëm mbi bazë ankimi nga subjekte të ndryshme në zbatim të ligjit Ligjit organik Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Gjatë vitit 2021 ka patur një rritje të numrit të ankesave të paraqitura në ISHMT për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale krahasuar me vitin 2020. Gjithsej 24 Kërkesë-Ankesa për shkelje të të drejtave mbi markat tregtare. Janë kryer **11 inspektime** dhe janë vendosur **8 masa administrative** nga të cilat 1 (një) masë administrative me paralajmërim dhe 7 masa administrative me gjobë.

⁷Në zbatim të Ligjit Nr. 35/2016 datë 31.03.2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të lidhura me to”, për subjektet /përdoruesit e programeve kompjuterike.

4. AKTIVITETEVE SENSIBILIZUESE/INFORMUESE

Në total nga ISHMT gjatë vitit 2021 janë realizuar 15 takime për informimin e operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve, pjesmarrje në 9 emisione televizive, printimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve informuese.

Për ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe të operatorëve ekonomikë për sigurinë e produkteve joushqimore janë realizuar:

- Intervistë në Tv News24, emisioni ALERT me tematikë “Konsumatori dhe Tregjet”, ku përfaqësues të ISHMT prezantuan fushë veprimtarinë e këtij institucioni dhe punën e bërë për sigurinë e produkteve joushqimore;
- Prezantimi në stacionin televiziv Report TV me temë “Sa të sigurta janë lodrat e fëmijëve”
- Prezantimi në stacionin televiziv Syri TV me temë “Sa të rrezikshme janë lodrat e fëmijëve”
 - Prezantimi në stacionin televiziv Neës 24 me temë “Rreziku në festa. Si të kujdesemi për ushqimin dhe produktet joushqimore
 - Prezantimi në stacionin televiziv A2 CNN me temë “Lodrat e rrezikshme, si t’i mbajmë fëmijët tanë të sigurt?”
 - Prezantimi në stacionin televiziv KLAN me temë “Lodrat për fëmijë të pacertifikuara, përmbajnë kimikate të rrezikshme”.



Për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, me mbështetjen e Projektit AL 17 IPA FI 01 20 "Forcimi i Mbrojtjes dhe Zbatimit të të Drejtave të Pronës Intelektuale" dhe projektit ALSIP të zyrës Zviceriane Të Pronësisë Intelektuale janë zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

- Seminar kombëtar për Pronësinë Intelektuale, adresuar juristëve dhe konsumatorëve në datat 26 -27 Prill 2021.
- Hartimi dhe printimi i 1000 broshurave informuese dhe materiale promovuese me logon e ISHMT.
- Fushatë ndërgjegjësuese 3-ditore, “ Informimi i Publikut”, në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale ku janë shpërndarë materiale informuese në standat e ngritura në pedonalen dhe liqenin e Tiranës. 26 Prill 2021
- Takime me 80 biznese në qytetin e Tiranës për informim në lidhje me funksionet e ISHMT dhe respektimin e të drejtave të PI si dhe janë shpërndarë materialet informuese. Prill 2021

- Publikimi i mesazhit të kryeinspektorit të ISHMT, për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale në portalin online “APEL media” . Prill 2021.
- Intervistë në Tv Neës24, emisioni ALERT me tematikë “Konsumatori dhe Tregjet”. ISHMT prezantoi funksionet e tij institucionale për sigurinë e produkteve joushqimore dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale në treg. 12 Maj 2021.
- TreSeminare online “Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale”, me pjesmarrjen e studentëve të Universitetit Polis, Universitetit Politeknik të Tiranës, Universitetit Epoka . Në këto takime janë prezantuar funksionet dhe kompetencat institucionale në mbrojtje të Pronësisë Intelektuale në tregun e brendshëm të RSH. 14-17-20 maj 2021.



- Pesë takime me biznesin dhe Dhomat e Tregëtisë, në qytetet e Durrësit, Shkodrës, Tiranë, Durrës, Berat, Gjirokastrë Korçë, Elbasan, Vlorë bashkëpunim me DPPI, DDA dt. 06.07.2021 dhe 13-15 dhe 20-24 Shtator 2021
- Panairi i produkteve shqiptare artizanale, drejtuar biznesit, në qytetin e Lezhës dhe rrethinat, në Fishtë Lezhë, bashkëpunim me DPPI, DDA. 13 Korrik 2021
- Informim publikut në bashkëpunim me DPPI dhe DDA në stendat e ngritura në liqenin e Tiranës, dt. 23-24 Shtator 2021.
- Konferencë Edukative në fushën e PI, adresuar mesuesve të arsimit fillor. ISHMT prezantoi rëndësinë e zbatimit të të drejtave të PI. 4-5 Tetor 2021.
- ISHMT mori pjesë në takim “Tryezë e rumbullaket me temë Rëndësia e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale, në këndvështrimin e biznesit”, organizuar nga DPPI, ISHMT prezantoi mbi funksionet e ISHMT në mbrojtje të të drejtave të PI në treg. 28 tetor 2021
- Janë informuar gjatë muajit Nëntor me email 30 biznese shqiptare mbajtës së drejtash të Pronësisë Industriale, për funksionet e ISHMT, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe masat administrative në rast shkeljeve të të drejtave të PI.
- Intervistë e Kryeinspektorit të ISHMT mbi zhvillimet në fushën e zbatimit të të drejtave të PI në "Neës24" TV "Progres Raporti i KE dhe Konsumatori". 3 Nëntor 2021.

Është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme **informacioni në ëeb-site** e ISHMT-së ëëë.ishmt.gov.al , si dhe rrjetet sociale për konsumatorët apo operatorët ekonomik

5. NGRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE

Në total janë kryer 22 trajnime me pjesëmarrjen e 52 inspektorëve. 50% e inspektorëve janë trajnuar më shumë se dy herë.

- Trajnim online Expert Group on Toys -24 Mars 2021;
- Takimi Adco Toys Group i përvitshëm për lodrat, në të cilin mblidhen përfaqësues nga autoritete te ndryshme te Mbikëqyrjes së Tregut-Komisioni European (European Commission), DG Groëth. 1 Qershor 2021
- Trajnim online mbi transpozimin e legjislacionit të BE-së, në fushën e mbikëqyrjes së tregut EU 2019/1020 dhe EU 2019/515 për vendet e Ballkanit Perëndimor (ËB6). 9 Qershor 2021
- Trajnim online mbi kërkesat bazë të Direktivës së Makinerive (2006/42/EC) për autoritetet e mbikëqyrjes së vendeve të WB6. 28 Shtator 2021
- Trajnim specifik online për trapanet, kërkesat specifike të sigurisë se tyre dhe hartimi i check-listave bazuar në standardin e tyre. 29 Shtator 2021
- Trajnim online “Përforcimi i kapaciteteve të inspektoreve të ISHMT në lidhje me kërkesat e sigurisë për produktet (ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorët)”. Ndalimi i tregimit të produkteve të pasigurta dhe praktikat më të mira për sa i përket ashensorëve në vendet e BE.18-19 Tetor 2021
- Trajnimit online “Fuqizimi i kapaciteteve të ISHMT në lidhje me kërkesat e sigurisë për pajisjet e gazit”. 11-12 Nëntor 2021.
- Trajnim mbi legjislacionin e kimikateve për inspektorët “ The need for preventive chemicals control” i organizuar nga Agjencia Suedeze e Kimikateve KEMI, (Kemikalieinspektionen). 1-2 Dhjetor 2021..
- Trajnim online mbi njohjen e legjislacionit për transportin e mallrave të rrezikshme dhe implementimin e tij. Ekspertë nga Gjermania dhe Polonia prezantuan praktikat e tyre më të mira dhe eksperiencat në kërkesat e Direktivës 2008/68/EC. 6-7 dhjetor 2021.

Me mbështetjen e projektit AL 17 IPA FI 01 20 "Forcimi i Mbrojtjes dhe Zbatimit të të Drejtave të Pronës Intelektuale" dhe projektit ALSIP të zyrës Zviceriane Të Pronësisë Intelektuale janë zhvilluar trajnimet e stafit të Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale si më poshtë:

- Shkëmbimi eksperiencave për procedurat e inspektimit nga entiteti zviceran STOP PIRACY. Prezantimi i platformës “STOP Piracy” dhe aktiviteteve që ky institucion mbulon”. Dt. 22.02.2021.



- Prezantimi i masave ligjore që Zvicra ka ndërmarrë në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për mospërdorimin e mallrave të falsifikuara”. 23.02.2021
- Objektet e Pronësisë Intelektuale gjatë Procesit të Inspektimit”, në datat 4-5 mars 2021.
- Rritja e Kapaciteteve Administrative mbi monitorimin e tregut. 11-12 mars 2021.
- Disenjt Komunitare dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit. Njohje me praktikat më të mira, metodologjitë e aplikuara nga BE, të aplikueshme në kazuset dhe çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. 15-16 prill 2021.
- Inspektimi për tregtinë online; Mënyrat e identifikimit, vlerësimit dhe konfirmimit të mallrave fallso, bllokimi dhe shkatërrimi i tyre; Veprimet që përbëjnë kundravajtje administrative dhe vepra penale në cënimin e të drejtave mbi PI; Inspektimi i programeve kompjuterike; Bashkëpunimi ndërinstucional në luftën kundër piraterisë dhe mallrave të falsifikuara; Shembuj konkretë nga puna dhe eksperiencia e DIMEA (Interagjensia e Monitorimit të Tregut) e Republikës së Greqisë”. Sesion trajnimi dy ditor adresuar vetëm stafit të ISHMT. Dt. 17-18 qershor 2021.
- Trajnim”Ndryshimet ligjore dhe institucionale , prezantimi me modelet e aplikuara të menaxhimit të PI në nivel Evropian”. 1 Shtator 2021
- Trajnim “Prezantim me standartet e aplikuara në vendet e BE për mbrojtjen e të drejtave të PI. 2 Shtator 2021.
- Trajnim “Mbi rregullat e BE -së në fushën e ligjit dhe politikës së pronësisë intelektuale dhe mbi rregulloret e aplikuara për inspektimet në tregun e brendshëm”.3 Shtator 2021
- Seminari Rajonal për Gjyqtarë dhe Profesionistë të PI, organizuar nga Zyra e Patentave e Republikës së Letonisë (LPO) në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO). 14 Shtator 2021
- Trajnim drejtuar Shkollës së magjistraturës, ISHMT prezantoi rëndësisë e zbatimit të të drejtave të PI, në rrugë administrative si një zgjidhje më e shpejtë dhe pa kosto për mbajtësit e të drejtave të PI. 7 Tetor 2021
- Sesion i përbashkët trajnimi midis DPPI, DDA, ISHMT dhe organeve rregullatore për çështjet e PI. 13-14 Tetor 2021.



- Vizitë studimore në Romë, Itali. Nga ky aktivitet ISHMT u njoh me sistemin Italian të mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale në të dy degët e saj, e drejta e autorit dhe pronësia industriale, legjislacionin, direktivat, rregulloret, institucionet ligjzbatuese për çështjet e lidhura me PI, si dhe për kundravajtjet penale dhe shkallet e gjyqimit në Itali dhe në BE për zgjidhjen e konflikteve mbi PI. 10-15 Tetor 2021.
- Workshop mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për sistemin e drejtësisë dhe institucionet e tjera ligjzbatuese. 7 Dhjetor 2021

6. MBËSHTETJE PËR PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E VEPRIMTARISË TË ISHMT-SË

Gjatë kësaj periudhe është kontribuar në hartimin e 1 draft ligji, 2 draft VKM, 1 draft strategji, 2 marrëveshje bashkëpunimi dhe në raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si pjesë e GNP.

- ✓ U miratuan dhe hynë në fuqi ndryshimet e Ligjit 9947 “Për Pronësinë Industriale”. Miratimi i këtyre ndryshimeve i krijon ISHMT-së mundësinë e realizimit të inspektimeve bazuar në procedura më të qarta për trajtimin e kërkesë ankesav nga mbajtësit e të drejtave dhe për inspektimet ex-officio. Për zbatimin e këtyre ndryshimeve është kërkuar support nga projekti zvicerian ALSIP për draftimin e analizës së riskut për inspektimet exofficio, hartimin e rregullores për shkatërrimin e mallrave të fasifikuara, hartimin e manualeve të procedurave të standardizuara të inspektimit.
- ✓ ISHMT ka përgatitur dhe dërguar pranë Sekretariatit Teknik (DPPI) draftin e dokumentit të ri strategjik në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale 2021-2025, bazuar në sugjerimet e ekspertëve të EİPO-s. Ky dokument përmban objektivat dhe indikatorët e ISHMT mbi mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- ✓ Analizë e bazës ligjore mbi mbrojtjen e pronësisë industriale në treg dhe diskutime mbi sugjerimet për përmirësimin e bazës ligjore (ISHMT, DPPI, DDA dhe ekspertë të projektit **AL 17 IPA FI 01 20**).
- ✓ Mendim rreth 2 akteve nënligjore ku ISHMT është një nga institucionet zbatuese: “Rregullore për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot, të vendeve të tjera dhe vendeve të treta sipas marrëveshjes shumëpalëshe” dhe Draft VKM “Për masat lidhur me sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja”.
- ✓ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet ISHMT dhe DPPI. Dt.23.09.2021.

- ✓ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet ISHMT dhe QKLL. Dt.23.09.2021
- ✓ Zhvillim i një plani për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut me fokus në manaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe implikimet nga falsifikimet dhe pirateria dhe (ISHMT, DPPI, DDA dhe ekspertë të projektit **AL 17 IPA FI 01 20**). Dt. 8-9 mars 2021.



- ✓ Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet shtetërore dhe grupet e tjera të interesit dhe fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit të brezit të ri” dhe “Hartimi i një plani trajnimi efektiv për gjyqtarët dhe studentët e shkollës së Magjistraturës” dhe dhe “Organizimi i Fushatës Edukative drejtuar shkollave për ngritjen e vetëdijes së përgjithshme për implikimet e falsifikimit dhe piraterisë” (ISHMT, DPPI, DDA dhe ekspertë të projektit **AL 17 IPA FI 01 20**).. Dt. 17. 03.2021 dhe Dt. 29.03.2021.



ISHMT në kuadër të përmbushjeve të detyrave të caktuara në **Kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale” dhe Kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik”** si pjesë e GNP, ka dhënë kontributin mbi analizën e raportit të Komisionit European për mangësitë e konstatuara në kuadër të këtyre kapitujve dhe masat

që duhen marrë me qëllim harmonizimin e legjislacionit. Ka koordinuar punën e nëngrupit III si institucion drejtues për institucionet e përfshira në zbatimin e mbrojtjes së të drejtave të PI, si dhe ka kontribuar në për hartimin e PKIE 2022-2024 kapitulli 7 “Pronësia Intelektuale”.

7. DETYRAT E PAREALIZUARA OSE TË REALIZUARA PJESËRISHT

7.1. Arsyet e mosrealizimit të çështjeve të parashikuara për vitin 2021

Gjatë vitit 2021 nuk u realizua:

Numri i planifikuar i inspektimeve.

Për vitin 2021 ishin planifikuar të kryheshin **3141 inspektime në total** nga të cilat **2472 tw** programuara dhe 668 tw pa programuara. Nga ISHMT janë realizuar **1745 inspektime** në total (55 %). Faktorët që kanë cuar në mosrealizimin e planit janë:

- Situata e jashtëzakonshme e krijuar nga Pandemia Covid 19, e cila ka ndikuar në numrin e kufizuar të stafit për shkak të infektiveve si dhe në gjetjen mbyllur të subjekteve për shkak të kësaj situatë.
- Mungesa e mjeteve të transportit për kryerjen e inspektiveve në të gjithë vendin.
- Shumë subjekte nuk janë gjetur në adresat që kanë deklaruar në QKB, disa kanë ndryshuar objektin e veprimtarisë dhe një pjesë janë gjetur mbyllur.

Përdorimi total i buxhetit.

Për sa i përket **buxhetit të miratuar për ISHMT** nga fondi i planifikuar prej 113.616.690.lekë janë shpenzuar 99.920.041 lekë , dmth 88% e buxhetit total është përdorur, sipas tabelës si mëposhtë:

	EMERTIMI	SHUMA (LEKË)
FONDET E CELURA		
600	Paga	69.940.000
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	13.800.000
602	Shpenzime korentë	20.156.000
231	Investime	9.720.690
TOTALI		113.616.690
FONDET E SHPENZUARA		
600	Paga	67.539.360
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	11.280.225
602	Shpenzime korentë	15.379.766
231	Investime	5.720.690
TOTALI		99.920.041

Për pagat e punonjësve të ISHMT janë paguar 67.539.360 lekë ose 97 % e totalit të pagave të çelura në fillim të vitit buxhetor 2021 në shumën 69.940.000lekë.

Po kështu për Sigurimet Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimet për pagat e marra nga punonjësit e ISHMT janë paguar 11.280.225lekë ose 82 % e totalit të vitit buxhetor 2021 në shumën 13.800.000 lekë të sigurimeve të çelura në fillim të vitit 2021 .

Për zërin e Investimeve janë përdorur 5.720.690lekë ose 59 % e totalit të vitit buxhetor 2021 në shumën 9.720.690lekë të çelura në fillim të vitit 2021 .

Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2021 janë realizuar investimet e mëposhtme:

- Blerje të pajisjeve dhe instrumentave për testim dhe inspektim në terren në vlerën 5.039.490lekë me Tvsh.
- Blerje pajisje kompjuterike (kompjuterat dhe laptop) në vlerën 681.200 lekë me Tvsh.

Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2021 nuk është realizuar investimi i mëposhtëm:

- Blerje automjete te ISHMT-së në vlerën 4 000 000 lekë me tvsh.

Për vitin 2021 janë arkëtuar nga gjobat **9 .050.071**lekë.

8. BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2021 është verifikuar listëprezenca e nënpunësve rregullisht si dhe është monitoruar zbatimi i Kodit të Etikës. ISHMT ka në organikë 80 punonjës, nga të cilët 72 janë të emëruar dhe 8 pozicione janë vakante.

8.1 Disiplina në punë, rekordet e orareve të punës

Gjatë vitit 2021 çdo punonjësi i ri është njohur me përshkrimet e punës, Rregulloren e Institucionit dhe Kodin e Etikës. Modulet e ëëbinareve të dërguara nga ASPA i janë bërë me dije punonjësve për ndjekjen e tyre. Rregullisht është verifikuar listprezenca dhe sistemi i hyrje-daljeve.

8.2 Performanca sipas kritereve

ISHMT funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhërin nr. 73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut e përbërë nga 4 njësi organizative (Drejtori), 8 njësi organizative (Sektorë) dhe me gjithësej 80 punonjës (Tab.2). Ky institucion e ushtron veprimtarinë e tij sipas Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhër të Ministrit Përgjegjës.

Në respektim të udhëzimeve nga Strukturat e Posaçme të Mbrojtjes së Shëndetit Publik, janë ndjekur të gjitha masat për parandalimin e përhapjes së Pandemisë COVID-19, aplikimi i punës online dhe në distancë për nëpunës që kanë shfaqur probleme shëndetsore dhe pajisja e nëpunësve me dezinfektatë dhe mjete mbrojtëse për parandalimin e sëmundjes.

8.3 Masa disiplinore të marra

Për periudhën Janar-Qershor 2021 është ngritur 1 komision disiplinor dhe është vendosur ndërprerje e ecurisë disiplinore.

8.4 Ngritje në detyrë, lëvizje paralele

Gjatë vitit 2020 janë kryer: 1 ngritje në detyrë; 1 lëvizje paralele, 7 pranime nga jashtë shërbimit civil; 1 transferim nga shërbimi civil, 3 lirime nga shërbimi civil dhe 3 pezullime.

8.5 Ankesat

ISHMT gjatë vitit 2021 ka trajtuar **115 ankesa**, 73 janë dorëzuar dorazi në protokollin e ISHMT-së, 2 kanë ardhur nga bashkëqeverisja, 32 kanë ardhur në e-mail-in e kontaktit të ISHMT-së, dhe 8 janë deleguar nga institucione të tjera shtetërore. (Tab.3)

9. MASAT E NDËRMARRA LIDHUR ME TASK FORCËN E ANTIKORRUPSIONIT

Mbështetur në Vendimin nr.247, datë 20.03.2015 “Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2021”, ISHMT ka marrë këto masa:

1. Ka implementuar portalin online E-Inspektimi;
2. Inspektimi kryhet me kite portabël;
3. Publikimi online i të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave dhe afatet (adresa ëeb e aksesueshme);
4. Hartimi i programit të transparencës sipas ligjit për të drejtën e informimit .

10. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022

Për vitin 2022 prioritetet e punës së ISHMT-së do të jenë:

Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore (Inspektimet)

Fokusi kryesor do të jetë në: A) grup-produktet që kanë rezultuar me problematika të ndryshme në vitet paraardhëse, që kanë një ndjeshmëri në treg si p.sh instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, parapaketimi, dekodera, karikues, llamba, etj, regjistrimi i ashensorëve në ISHMT, produkte për të cilat deri tani, nuk ka patur veprimtari mbikëqyrëse si: kimikate dhe artikujt piroteknik; B) respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në vitin 2022 do të realizohen në total **2498 inspektime të programuara dhe 588 të pa programuara**, nga të cilat 1877 inspektime të programuara dhe 469 të pa programuara në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore dhe 621 inspektime të programuara dhe 119 të pa programuara në fushën e pronësisë intelektuale.

Nr.	ISHMT	Numër inspektimesh total	Nr inspektimesh të programuara
1	Drejtoria e Produkteve Joushqimore	2346	1877
1.1	Sektori i Produkteve mekanike	414	331
1.2	Sektori i Produkteve Elektrike	345	276
1.3	Sektori i qelqit, këpucëve, detergjentëve/sigurisë së produkteve	552	442
1.4	Sektori i Inspektimit Metrologjik	1035	828
2	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale	690	621
2.1	Sektor i Pronësisë Industriale	0	0
2.2	Sektori i të Drejtës së Autorit	690	621
	TOTALI	3140	2498

Informimi

- Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjore mbi sigurinë e produkteve joushqimore si dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator.

Fuqizimi i Kapaciteteve njerëzore

Trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse.

Bashkëpunimet ndërinstitucional dhe Rajonal

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale.
- Fuqizimi i bashkëpunimit të ISHMT-së me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut të vendeve të Rajonit për shkëmbim eksperience dhe të Përvojave më të mira.

11. PROBLEMATIKAT

- Mungesa e automjeteve për inspektim të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve , duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale (i gjithë territori i vendit) të ushtrimit të funksionit të ISHMT-së.
- Mangësi në vlerësimin e sigurisë së produkteve nëpërmjet aparaturave dhe pajisjeve e cila lidhet jo vetëm me numrin shumë të kufizuar të këtyre pajisjeve dhe aparaturave, por edhe me mungesën e trajnimeve më të avancuara për përdorimin e tyre.
- Mungesa e një procedure për produktet që duhet t’i nënshtrohet analizave laboratorike në laboratorë të huaj, duke patur në konsideratë që në Shqipëri ekziston vetëm një laborator i akredituar për analizat e tekstitit dhe lëkurës, ndërsa për produkte të tjera që janë në fokusin e inspektimit të ISHMT-së si : lodra, detergjentë, produkte të kujdesit për fëmijë, etj., analizat duhet të kryhen në laboratore të akredituar të huaj.
- Buxheti i limituar i vënë në dispozicion për këtë inspektorat duke pasur në konsideratë gamën e gjerë të produkteve që mbulon për inspektim si dhe mbulimin e gjerë territorial të vendit.
- Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB.
- Mungesë eksperience e stafit në fushën e inspektimit dhe në fushat specifike që janë në fokusin e ISHMT-së. Shumë prej fushave si siguria e produkteve elektrike, mekanike, qelq/këpuca/detergjentet, pronësia industriale, janë fusha që kërkojnë një staf të trajnuar dhe të formuar profesionalisht.
- Mungesa e kитеve për kryerjen e procedurave të inspektimit online në platformën e-inspektimi.
- Shkalla e ulët e informimit të subjekteve, në lidhje me kuadrin ligjor dhe detyrimet që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuar sipas fushave specifike, inspektimi i të cilave është në fokusin e ISHMT-së, është një nga problemet që vështirësojnë së tepërmi punën e ISHMT-së.

ANEX

Tabela 1: Inspektimet sipas sektorëve dhe grup-produkteve, 2021

	Fushë veprimtaria	Inspektime te programuara tw planifikuar	Inspektime te pa programuara tw planifikuar	Inspektime të kryera	Masa administrative gjithsej	Gjoha	Paralajmërimë	Masa urgjente	Numër produktesh të kontrolluara	Numër produktesh të kontrolluara jo në konformitet
1	Inspektimi Metrologjik	927	232	515	4	4	-	-	3318	10
1.1	<i>Parapaketim</i>			310	1	1	-	-	1384	1
1.2	<i>Instrumentat matëse ligjërish të kontrolluara</i>			28	-	-	-	-	705	-
1.3	<i>Inspektime për Instrumentat matëse ligjërish të kontrolluara që vendosen në treg</i>			2	-	-	-	-	1	-
1.4	<i>Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, në përdorim</i>			175	3	3	-	-	1228	9
2	Inspektimi i produkteve elektrike	309	77	172	18	6	-	12	558	50
3	Inspektimi i produkteve/pajisjeve mekanike (ashensorë, PMP, makineri)	309	77	345	95	32	61	2	563	213
3.1	<i>Ashensorë</i>			336	95	32	61	2	535	213
3.2	<i>Makineri</i>			2	-	-	-	-	11	-
3.3	<i>PMP</i>			28	6	6	-	-	310	5
4	Inspektimi i produkteve qelq/këpucë/sig produkteve (lodra, tekstil, veshje këmbe)	309	77	189	32	19	4	9	3685	54
4.1	<i>Lodra</i>			82	19	11	-	8	2607	25
4.2	<i>Detergjentë</i>			-	-	-	-	-	-	-
4.3	<i>Veshje këmbe</i>			-	-	-	-	-	-	-
4.4	<i>Mbrojtja e konsumatorit</i>			72	5	2	3	-	745	9
4.5	<i>Siguria e përgjithshme</i>			14	2	-	1	1	40	15
5	E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me to	618	155	513	80	53	27	-	-	-
6	Inspektimi për të drejtat e Pronësisë Industriale	-	50	11	8	7	1	-	-	-
	TOTALI	2472	668	1745	237	121	93	23	8124	327

Tabela 2: Staffi i ISHMTsë sipas sektorëve dhe drejtorive

	Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar	Numri aktual i punonjësve	%
DREJTORIA TEKNIKE	7	5	60
DREJTORIA E MBIQEQRJES SE PRODUKTEVE	42	37	88
Spektori I Produkteve Elektrike	7	5	71
Spektori I Produkteve Mekanike	9	7	78
Spektori I Metrologjisë	16	15	94
Spektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme	9	9	100
DREJTORIA E PRONESISE INTELEKTUALE	18	17	94
Spektori I Pronësisë Industriale	7	6	86
Spektori I të Drejtave të Autorit	10	10	100
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	12	11	92
Spektori juridik dhe shërbimeve mbështetëse	8	8	100
Spektori I Financës	3	2	67
	80	71	89%

Tabela 3: Numër ankesash të trajtuara nga ISHMT, 2021

Nr	Institucioni/Organi/	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTALI
1	Ankesa nga Bashkëqeverisja								1				1	2
2	ankesa - \web site ISHMT/e-mail zyrtar	1	2	4	1	2		5	2	11	2	2	0	32
3	Ankesa dorëzuar në protokoll ISHMT	2	2	1	4	7	10	2	12	11	10	5	7	73
4	Ankesa deleguar nga institucione të tjera		1		1				3		2		1	8
	TOTALI	3	5	5	6	9	10	7	18	22	14	7	9	115